



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.286/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit M. K.i, kundër të paditurit F. R. D. nga fsh..., Komuna e G., për shkak të rimbursimit të dëmit, përkitazi me revizionin e të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5657/19 datë 17.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 1.08.2023, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pathemeltë revizioni i të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5657/19 dt.17.05.2023.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5657/19 dt.17.05.2023, refuzohet si e pathemeltë ankesa e të paditurit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc C.nr.150/15 dt.9.08.2019, me të cilin, aprovohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar dhe detyrohet i padituri, që paditëses, në emër të rimbursimit – regresimit të dëmit të ia paguajë shumën prej 30,689.00 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat e Kosovës pa destinim kthimi mbi një vit duke filluar nga dt.24.08.2015 e deri në pagesën definitive

si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 153,44 euro, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ka paraqitur revizion i padituri për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni, ndërsa, aktgjykimet e instancave më të ulëta të prishen dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë dhe të urdhërohet shtyrja e ekzekutimit të aktgjykimit në të gjitha pjesët e tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, pretendimeve të revizionit si dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja më dt.24.08.2015 ka parashtruar padi, në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurit, për shkak të rimbursimit (regresit) të dëmit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që të paguajë shumën e sipër cekur, lidhur me dëmin e shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i dt.8.05.2008, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë. Nga raporti policor, vërtetohet se i padituri e ka drejtuar automjetin e markës “Ford Siera“, me targa të regj. ..., i cili ka qenë i pa regjistruar dhe i pa siguruar. I njëjti, në bazë të aktgjykimit penal të Gjykatës Komunale në Lipjan P.nr.78/09 dt.3.04.2009, është shpallur fajtor për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit dhe është gjykuar sipas ligjit, me dënim përkatës, kurse, me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.18/09 dt.1.03.2010, është detyruar e paditura ( këtu paditësja), që të dëmtuarit ( paditësit ) E. M., ( me të dhënat tjera si në shkresat e kësaj lënde ) t’ia kompensojë dëmin, ku në bazë të urdhër pagesës, përkatësisht, nga raporti i B. E. në P. i dt.20.02.2015, vërtetohet se, këtu paditësja, i ka paguar shumën prej 30,689.00 euro, në llogari të Përmbaruesit Privat F. H. në P., nr.20-11-... në TEB Bankë.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ndaj, të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka aprovuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka vlerësuar se e njëjta drejt ka vërtetuar

gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ndaj, e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes juridiko civile, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse në arsyetim janë dhënë arsytet e mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet e pretenduara procedurale dhe materiale nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët gjyqësore, kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, përkatësisht dispozitat e nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe e ka obliguar të paditurin që asaj t'ia rimbursojnë dëmin në shumën e sipër përmendur.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes civile-juridike, e duke pasur parasysh dispozitat e nenit 18 par.1 dhe par. 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, në të cilat shprehimisht përcaktohet se ” Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja ”, përkatësisht, “Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat ”. Nga këtu, edhe kjo gjykatë, vlerëson se gjykata e instancës më të ulët, drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe në këtë drejtim, vendimi i saj është i drejtë dhe i ligjshëm. Prandaj, nuk qëndrojnë as pretendimet e revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Gjithashtu, sa i përket propozimit të paraqitësit të revizionit, për shtyrjen e ekzekutimit të aktgjykimit, në këtë fazë të procedurës, kjo gjykatë, vlerëson se për një propozim të tillë nuk përmbushen kushtet ligjore të parapara me dispozitat e nenit 60 – 64 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Nga sa u theksua më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.286/2023 datë 1.08.2023

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha.